

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA TASHI KUNDËR SHQIPËRISË
(*kërkesa nr. 1351/19*)

VENDIM

STRASBURG

13 janar 2026

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Tashi kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 1351/19) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë, më 28 dhjetor 2018, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetase shqiptare, znj. Evgjeni Tashi (“kërkuesja”), lindur në vitin 1959, me banim në Tiranë dhe e përfaqësuar nga z. E. Rusi, avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”) e përfaqësuar z. O Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 2 dhjetor 2025,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Në vitin 1966, babai i kërkueses bleu një shtëpi dhe ndërtoi një mur rreth saj.
2. Më 27 qershor 2008, Inspektorati i Ndërtimit dhe Planifikimit Urban (“Inspektorati i Ndërtimit”) urdhëroi shembjen e murit me arsyetimin se ishte ndërtim i paligjshëm. Shembja e murit ndodhi në vitin 2008.
3. Më 12 mars 2010, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi padinë e babait të kërkueses ndaj Inspektoratit të Ndërtimit. Ajo vlerësoi se muri nuk kishte qenë ndërtim i paligjshëm, prishi vendimin për shembjen e tij, dhe e detyroi Inspektoratin e Ndërtimit të rindërtonte murin 14.3 m të gjatë dhe 1.8 m të lartë. Më 10 maj 2011, Gjykata e Apelit e la në fuqi atë vendim. Në qershor 2011, u lëshua një urdhër ekzekutimi.
4. Më 1 korrik 2011, babai i kërkueses nisi procedurat përmbarimore me anë të një përmbaruesi.
5. Më 22 korrik 2011, përmbaruesi theksoi në raportin e tij zyrtar se muri do të ndërtohej nga babai i kërkueses nën mbikëqyrjen e tij, si pjesë e procedurave përmbarimore të vendimit të vitit 2011.
6. Më 7 nëntor 2011, përmbaruesi kërkoi që Inspektorati i Ndërtimit të rimbursonte shpenzimet e bëra nga babai i kërkueses për rindërtimin e murit. Autoritetet Shtetërore nuk kanë nisur ndonjë proces ndaj masave të përmbaruesit apo të babait të kërkueses.

7. Më 5 shkurt 2015, babai i kërkuesses ndërroi jetë dhe kërkuessa vijoi procesin e brendshëm në vend të si një prej tre trashëgimtarëve të tij.

8. Më 26 shkurt 2015, Gjykata e Lartë la në fuqi pjesërisht vendimin e Gjykatës së Rrethit 2010 në lidhje me prishjen e vendimit të Inspektoratit të Ndërtimit, dhe e ndryshoi atë pjesërisht duke i akorduar dëm pasuror babait të kërkuesses në vend që t'i urdhëronte autoritetet të rindërtonin murin.

9. Më 8 mars 2017, kërkuessa nisi procesin për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

10. Më 2 tetor 2018, kërkuessa dhe trashëgimtarët e tjerë u gjobitën nga Inspektorati Kombëtar i Ndërtimit dhe Planifikimit Urban ("Inspektorati Kombëtar i Ndërtimit") me argumentin se muri me gjatësi 36 m ishte ndërtim i paligjshëm, dhe u lëshua një vendim për shembjen e tij. Shembja e tij ndodhi më 17 tetor 2018.

11. Më 26 dhjetor 2018, Gjykata Administrative Tiranë pranoi kërkesën e kërkuesses për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shembja e murit në vitin 2018. Procesi vijon ende pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

12. Më 6 korrik 2022, autoritete Shtetërore ekzekutuan vendimin e Gjykatës së Lartë, duke paguar kompensimin pasuror dhe më 28 shkurt 2023, autoritete paguan kostot dhe shpenzimet për procedurat e përmbarimit.

13. Në mbështetje të nenit 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës, si edhe në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuessa u ankua se ishte shkelur parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e saj ndaj pronës, sepse vendimi i vitit 2015 dhënë në favor të babait të saj nuk ishte ekzekutuar, dhe muri ishte prishur për herë të dytë.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

14. Parashikimet përkatëse në lidhje me mjetin kompensues për kohëzgjatjen e procesit përcaktohen të *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* (nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 37, 12 tetor 2021) dhe *ARB sh.p.k. dhe të Tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 39860/19 dhe 2 të tjerë, §§ 65-76, 27 maj 2025).

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Siguria juridike

15. Kërkuessa u ankua në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës se shembja e dytë e murit rrethues në shtëpinë e babait të saj kishte shkelur parimin e sigurisë juridike.

1. Pranueshmëria

16. Qeveria parashittoi se ankesa ishte e parakohshme duke qenë se procesi i kompensimit për shembjen e dytë të murit ishte ende pezull.

17. Gjykata vëren se ankesa e kërkuesses ka lidhje me shkeljen e parimit të sigurisë juridike për ligjshmërinë e murit të shembur, sipas një vendimi të formës së prerë, dhe jo për kompensimin për shembjen e dytë të murit, që është ende duke u shqyrtuar pranë gjykatave të brendshme (shih paragrafin 11 më sipër). Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se kjo ankesë nuk është e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës, apo e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

2. Meritat

18. Kërkuessa argumentoi se ligjshmëria e murit ishte konfirmuar në grupin e parë të procedurave, dhe rindërtimi i murit në vitin 2011 ishte bërë nën mbikëqyrjen e përmbaruesit dhe mbështetur në vendimin e Gjykatës së Apelit, që ishte i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm. Masat e përmbaruesit nuk u kundërshtuan asnjëherë nga autoritetet Shtetërore.

19. Qeveria argumentoi se autoritetet e brendshme kishin vepruar në përputhje me parashikimet ligjore. Muret e prishur në vitin 2008 dhe 2018 nuk ishin të njëjtë. Muri i dytë ishte 36 m në krahësim me murin e parë që ishte 14.3 m, dhe për këtë arsye, nuk ishte shkelur parimi i sigurisë juridike.

20. Gjykata vëren se e drejta për t'u dëgjuar pranë një gjykate e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës duhet të interpretohet sipas Preambulës së Konventës, ku midis të tjerash përcaktohet se shteti i së drejtës është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Kontraktuese. Një prej aspekteve themelore të shtetit të së drejtës është parimi i sigurisë juridike, i cili parashikon, ndër të tjera se në rastin kur gjykatat kanë marrë një vendim të formës së prerë për një çështje, vendimmarrja e tyre nuk duhet të dihet në dyshim (shih *Brumărescu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28342/95, § 61, GJEDNJ 1999-VII; *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, §§ 51-56, GJEDNJ 2003-IX; dhe *Ro'ca kundër Moldavisë*, nr. 6267/02, § 24, 22 mars 2005). Gjykata përsërit se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate, e garantuar nga neni 6 § 1, do të ishte e gënjeshtërt nëse sistemi juridik i një Shteti Kontraktues do të lejonte që një vendim gjyqësor, detyrues, i formës së prerë të mbetej jofunksional në dëm të njëres palë (shih *Stoyanov dhe Tabakov kundër Bullgarisë* (nr. 2), nr. 64387/14, § 51, 7 dhjetor 2021, me referenca të tjera).

21. Për sa i përket çështjes konkrete, në fund të grupit të parë të procedurave, gjykatat e brendshme arritën në përfundimin se muri rrethues i shtëpisë së babait të kërkueses kishte qenë ndërtim i ligjshëm. Muri i dytë u ndërtua për të zëvendësuar të parin nën mbikëqyrjen e përmbaruesit gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit të vitit 2015 (shih paragrafët 4–6 më sipër). Gjykata vlerëson se autoritetet vendase nuk i kundërshtuan masat e përmbaruesit dhe as nuk nisën ndonjë procedurë në lidhje me ndërtimin ose përmasat e murit të ri. Qeveria nuk parashittoi se raporti përmbarimor i hartuar nga përmbaruesi në vitin 2011, apo kërkesa e përmbaruesit për shlyerjen e shpenzimeve, të ishin kundërshtuar pranë gjykatave të brendshme dhe as nuk paraqiti ndonjë argument se kishte arsye për ta bërë këtë. Pavarësisht nga sa më sipër, Inspektorati Kombëtar i Ndërtimi, pas më shumë se dhjetë vjetësh nga rindërtimi, arriti në përfundimin se muri ishte ndërtim i paligjshëm dhe e shembti atë (shih paragrafin 10 më sipër). Sidoqoftë, muri i rindërtuar u shemb i gjithi, duke përfshirë pjesën që ishte deklaruar e ligjshme nga gjykatat.

22. Këto fakte tregojnë se, me shembjen e murit për herë të dytë, autoritetet administrative nuk respektuan vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 26 shkurt 2015 që konfirmonte se muri ishte ndërtim i ligjshëm. Masat e Autoriteteve Shtetërore e kanë lënë kërkuesen në një gjendje pasigurie të vazhdueshme dhe e kanë bërë të pamundur ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhënë në favor të saj.

23. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se shembja e dytë e murit rrethues së shtëpisë së babait të kërkueses vuri në dyshim vendimin e formës së prerë të dhënë në grupin e parë të procesit, dhe gjykon se përbën një shkelje të parimit të sigurisë juridike të parashikuar në nenin 6 § 1 të Konventës.

B. Kohëzgjatja e procesit të përmbarimit

24. Kërkuësja u ankua për mosekzekutim ose ekzekutim të vonuar të vendimit të vitit 2015 dhënë në favor të saj.

25. Qeveria parashittoi se në vitin 2023, vendimi rezultonte të ishte i ekzekutuar. Për sa ka të bëjë me ekzekutimin e vonuar, Qeveria argumentoi se kërkuësja nuk kishte paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit kërkesën për njohjen e kohëzgjatjes së tepër të procedurave, mbështetur në nenin 399/6 të Kodit të Procedurës Civile (shih referencën në paragrafin 14 më sipër), dhe, në vijim, kërkesën për dëmshpërblim të drejtë. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, në këtë mënyrë kërkuësja nuk kishte shfrytëzuar mjetet vendase.

26. Gjykata mban në konsideratë faktin se autoriteteve iu deshën shtatë vite të ekzekutimit të vendimit të vitit 2015 (shih paragrafët 12 më sipër) dhe se ata nuk bënë të gjitha përpjekjet e nevojshme për ta zbatuar atë vendim në kohën e duhur. Megjithatë, mbështetur në nenin 399/6 të Kodit të Procedurës Civile, kërkuësja duhej të kishte paraqitur një kërkesë për njohjen e kohëzgjatjes së tepërt të procesit pranë Gjykatës së Rrethit. Në parim, Gjykata e vlerëson efikas mjetin kompensues për kohëzgjatjen e tepër të procesit (shih *Bara dhe Kola*, §§ 110-18, dhe *ARB SHPK dhe të Tjerë*, §192, të dy cituar më sipër). Kërkuësja nuk e ka shfrytëzuar këtë mjet.

Për këtë arsye, ankesa në lidhje me kohëzgjatjen e mosekzekutimit duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrim të mjeteve të brendshme.

II. ANKESA TË TJERA

27. Ankuesja u ankua edhe në mbështetje të nenit 13 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës për mungesën e pretenduar të mjetit efektiv dhe për shkeljen e së drejtës së saj ndaj pasurisë, në lidhje me ankesën për mosekzekutimin e vendimit të brendshëm të formës së prerë.

28. Për sa u përket fakteve të çështjes, parashtrimeve të palëve dhe gjetjeve të saj, Gjykata vlerëson se ajo ka shqyrtuar çështjet kryesore juridike të ngritura në çështjen konkrete. Në këtë mënyrë, ajo konstaton se nuk është e nevojshme të jepet një vendim i veçantë për këto ankesa (shih *Qendra për Burimet Juridike në emër të Valentin Cmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

ZBATIM I NENIT 41 TË KONVENTËS

29. Në parashtrimet e saj, kërkuesja kërkoi dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror pa përcaktuar ndonjë shumë. Megjithatë, në kërkesën e saj pranë Gjykatës, ajo kishte kërkuar 620,800 lekë shqiptar (ALL) për dëmin pasuror për kostot e rindërtimit dhe për çdo dëm tjetër, dhe 10,000 euro (EUR) për dëmin jopasuror. Kërkuesja nuk kishte bërë kërkesë për kostot dhe shpenzimet.

30. Qeveria i kundërshtoi këto kërkesa si të pajustificuara dhe argumentoi se kërkuesja nuk kishte formuluar një kërkesë për dëmshpërblim të drejtë.

31. Nën rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vëren se është e vërtetë se kërkuesja kërkonte shuma specifike për dëmin pasuror dhe jopasuror, vetëm në formularin e kërkesës. Megjithatë, në vërejtjet e saj parashtruar brenda afatit përkatës, ku u ftua shprehimisht të formulonte kërkesat e saj për dëmshpërblim të drejtë, kërkuesja e shprehu qartazi kërkesën për dëm pasuror dhe jopasuror, pavarësisht se nuk e përcaktonte shumën. Për këtë arsye, nuk mund të thuhet se ajo nuk parashtroi kërkesa për justifikim të drejtë brenda afatit përkatës në përputhje me rregullin 60, ku theksohet se dëmi jopasuror nuk e mundëson përlllogaritjen precize dhe se një kërkesë e tillë nuk është gjithmonë e nevojshme të përcaktohet nga kërkuesit (shih *Svrtan kundër Kroacisë*, nr. 57507/19, § 105, 3 dhjetor 2024.)

32. Duke u kthyer tek kërkesa për dëmin pasuror, Gjykata vëren se kërkuesja ka marrë kompensimin përkatës të dhënë nga gjykatat e brendshme për koston e rindërtimit. Për këtë arsye, ajo e rrëzon këtë kërkesë. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se kërkuesja duhet të ketë vuajtur edhe dëm jopasuror si rezultat i shkeljes së konstatuar. Duke bërë këtë vlerësim mbi baza të barabarta, siç kërkohet në nenin 41 të Konventës, ajo i akordon kërkueses 3,600 euro për dëmin jopasuror.

PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË UNANIME, GJYKATA:

1. *E shpall* të pranueshme ankesën bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa ka të bëjë me parimin për sigurinë juridike dhe ankesën për kohëzgjatjen e procesit të papranueshme;

2. *Gjykon* se është shkelur parimi i sigurisë juridike sipas nenit 6 § 1 të Konventës për shembjen nga autoritetet e brendshme të murit rrethues të shtëpisë së babait të kërkueses në vitin 2018;

3. *Gjykon* se nuk është e nevojshme që pranueshmëria ose meritat e ankesave të kërkueses sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 dhe nenit 13 të Konventës të shqyrtohen të ndara;

4. *Gjykon*:

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkueses, brenda tre muajve, 3,600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për dëmin jopasuror, të konvertuar në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në shlyerje interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në normën e barabartë me normën marginale

të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindjeje;

5. *Rrëzon* pjesën e mbetur të kërkesës së kërkuases për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 13 janar 2026, në mbështetje të rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE